



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975,
DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 2, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Vlera e mjetit plotësohet në sistemin informatik të DPTSHRR-së, kur mjeti regjistrohet për herë të parë ose/dhe sa herë ndryshon pronësia e tij. Vlera e mjetit, për efekt të klasifikimit “Automjet luksoz”, reduktohet çdo vit me 10% të vlerës së mbetur.

Për automjetet të cilat shiten, vlera e shitjes së tyre, për efekt klasifikimi si “Automjet luksoz”, nuk mund të jetë më e vogël se vlera e mjetit të amortizuar, sipas paragrafit të mësipërm.”.

Neni 2

Në pikën 3, të nenit 4, bëhen këto ndryshime:

- a) Fjalët “... prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit ...” zëvendësohen me “... sipas nenit 114, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ...”.
- b) Fjalët “... 18 për qind ...” zëvendësohen me “... 25 për qind ...”.

Neni 3

Neni 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“Neni 7
Taksa që vilet nëpërmjet pullës**

Taksa kombëtare, që vilet nëpërmjet pullës, është taksa e akteve të gjendjes civile.”.

Neni 4

Në shkronjën “g”, të pikës 2, të nenit 8, fjalët “... 0 (zero) për qind ...” zëvendësohen me “... 5 (pesë) për qind ...”.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

- a) Në shkronjën “ç”, të pikës 1, pas fjalëve “... invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë ...” shtohen “... personat me aftësi të kufizuara ...”.
- b) Në pikën 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.”.

- c) Në pikën 7, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2020.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI